

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZRËN-Departamenti i përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Sadije Selmani, me procesmbajtësen Luljeta Luboteni- sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. B. nga fshati , Komuna e S. , i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i përgjithshëm, PP/II.nr.2541/14 të datës 02.02.2016, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 të KP-së, në shqyrtimin fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit-Metush Biraj, të akuzuarit dhe të dëmtuarit H. Q. me datë 16.03.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari:

S. B. , nga i ati H. dhe e ëma S. e vajzërisë E. , i lindur me , në P. tani jeton në fshatin , Komuna e S. ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i ati i një fëmiju, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 07.10.2014, rreth orës 10:00, në Prizren, saktësisht përball shkollës speciale "Lef Nosi", në lagjen Lakuriq, duke mos iu përmbajtur dispozitave të komunikacionit në rrugë, shkel ligjin mbi trafikun publik, rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë, vepron në kundërshtim me nenin 42, 150 dhe 225 të LSKRR-së, në atë mënyrë që i pandehuri, duke drejtuar automjetin e markës "VW 70X02D", me targa të regjistrimit , ngjyrë të bardhë, kur arrin në vendin kritik, nuk lëvizë me kujdes të shtuar si dhe nuk ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave të komunikacionit, poashtu në mungesën e përvojës së drejtuarit të automjetit (pasi nuk posedonte patentë shofer) merr veprim për lëvizje mbrapa, pa u bindur se një veprim të tillë mund ta bëjë pa i penguar pjesëmarrësit tjerë në trafik, ku si pasoj me pjesën e pasme të automjetit "VW 70X02D", e godet të dëmtuarin H. Q. i cili ishte duke lëvizur përgjatë kësaj rruge, me ç'rast i dëmtuari pëson dëmtime të rënda trupore dhe ate: kontuzione në gjurin e majtë, ç'vendosje (llukacion) i artikulacionit – humero-shkapularë (krahut) të majtë, lëndime këto të përshkruara më për së afërmi në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor, Dr.N. H. të dt.24.12.2014.

-Këso dore kryen veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me par.6 të KP-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të neneve 4, 6, 7,17, 41, 42, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73 dhe nenin 378 paragrafi 8 lidhur me par.6 të KP-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 2 (dy) viteve, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

I dëmtuari H. ... (G. ... Q. ... nga P. ... rr. ...), nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

I akuzuari S. ... B. ... obligohet që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe ate: për ekspertizën mjekoligjore shumë prej 20.00 euro, në emër të ekspertizës së komunikacionit shumë prej 40.88 euro si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, prokurori i shtetit, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.2541/14 të datës 02.02.2016, kundër të akuzuarit S. ... B. ... nga fshati ... Komuna e S. ... për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me par.6 të KP-së.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar shqyrtimin fillestar, në të cilin i akuzuari S. ... B. ... ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së PTH-së.

Bazuar në pranimin e fajësisë, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari S. ... B. ... në ditën kritike me datë 07.10.2014, rreth orës 10:00, në Prizren, saktësisht përball shkollës speciale "Lef Nosi", në lagjen Lakuriq, duke mos iu përmbajtur dispozitave të komunikacionit në rrugë, shkel ligjin mbi trafikun publik, rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë, vepron në kundërshtim me nenin 42, 150 dhe nenin 225 të LSKRR-së, në atë mënyrë që i pandehuri, duke drejtuar automjetin e markës "VW 70X02D", me targa të regjistrimit ... ngjyrë të bardhë, kur arrin në vendin kritik, nuk lëvizë me kujdes të shtuar si dhe nuk ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave të komunikacionit, poashtu në mungesën e përvojës së drejtuarit të automjetit (pasi nuk posedonte patentë shofer) merr veprim për lëvizje mbrapa, pa u bindur se një veprim të tillë mund ta bëjë pa i penguar pjesëmarrësit tjerë në trafik, ku si pasoj me pjesën e pasme të automjetit "VW 70X02D", e godet të dëmtuarin H. ... Q. ... i cili ishte duke lëvizur përgjatë kësaj rruge, me ç'rast i dëmtuari pëson dëmtime të rënda trupore dhe ate: kontuzione në gjurin e majtë, ç'vendosje (llukacion) i artikulacionit –humero-shkapularë (krahut) të majtë, lëndime këto të përshkruara më për së afërmi në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor, Dr.N. ... H. ... të dt.24.12.2014.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari S. ... B. ... i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat. Gjykata sipas detyrës zyrtare nuk ka gjetur se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari, ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht nga ana e tij, se pranimi i fajësisë mbështet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza dhe se i akuzuari prej fillimit të hetimeve e gjerë në këtë shqyrtim ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat i ka paraqitur përfasuesi i aktakuzës dhe të cilat asnjëherë nuk i ka kundërshtuar dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësin e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethanë posaqërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, si dhe rrethanat tjera lehtësuese, rrethanat personale- është kryefamiljar dhe mbajtës i vetëm i familjes, gjendjen e tij të rëndë ekonomike, pasi që bashkëshorten e ka të sëmur nga një sëmundje e rëndë poashtu edhe djali i tij ka pasur intervenim në zemër, me ç'rast ka pasur shpenzime të larta rreth trajtimit të tyre, ka shprehur keqardhje e poashtu gjykata pati parasysh edhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij dhe se ky lloj i dënimit, sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se çdo dënim tjetër nga ai i shqiptuar me këtë aktgjykim do të ndikonte negativisht në jetën e tij dhe të familjes si tërësi, e sidomos kujdesin financiar ndaj familjes.


Vendimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450 dhe 453 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.233/2016, me datë 16.03.2017

Procesmbajtësja
Luljeta Luboteni
Luboteni



Gjyqtarja e vetme gjykuese
Sadije Selmani

Sadije Selmani

UDHËZIM JURIDIKË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.